

**VENDIM**  
**Nr. 568, datë 17.7.2019**

**PËR KRIJIMIN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË**  
**AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT**

*(Ndryshuar me VKM nr. 186, datë 25.3.2021)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 59, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në vijim AKM, si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin, në vijim “ministri”), me seli në Tiranë. AKM-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme.

2. AKM-ja ka për mision mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, përdorimin e matur dhe racional të natyrës e të burimeve të saj në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

**II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT**

AKM-ja ka këto funksione kryesore:

1. Sigurimin e performancës mjedisore;
2. Kërkimin dhe dijen mjedisore;
3. Vlerësimin e impaktit mjedisor dhe licencimin;
4. Inspektimin dhe kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.

**III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT**

1. AKM-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet në 2 nivele:

- a) Nivel qendror, përmes Drejtorisë së Përgjithshme;
- b) Nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) agjencive rajonale të mjedisit (ARM).

2. Ministri miraton me urdhër shtrirjen territoriale të ARM-ve dhe qarkun ku do të ngrihet Agjencia Rajonale e Mjedisit.

3. AKM-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e saj dhe përgjigjet përpara ministrit. Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson AKM-në në marrëdhëniet me të tretët. Agjencitë rajonale të mjedisit drejtohen nga drejtuesit përkatës të tyre dhe raportojnë te drejtori i Përgjithshëm i AKM-së.

4. Struktura dhe organika e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe e agjencive rajonale të mjedisit miratohen nga Kryeministri, sipas përcaktimeve në legjisllacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në përputhje me përgjegjësitë e veta, kryen këto detyra:

5.1 Në lidhje me sigurimin e performancës mjedisore:

- a) përcaktimin e standardeve, kritereve mjedisore dhe metodologjive/udhëzuesve për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit;

b) vlerësimin e vazhdueshëm të statusit mjedisor, rolit të aktivitetit njerëzor e natyror mbi mjedisin si dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi rëndësinë e mjedisit;

c) përcaktimin e objektivave mjedisore duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme për realizimin e tyre, kriteret dhe treguesit (KPI/benchmark) e performancës së mjedisit në përputhje me kërkesat e BE-së si dhe nëpërmjet organizimit e vlerësimit funksional të sistemit/të sektorit të mjedisit;

ç) garantimin e ndërveprimit të efektshëm dhe angazhimit/pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm (institucione, shoqëria civile, biznesi, komunitetet dhe qytetarët).

5.2 Në lidhje me kërkimin dhe dijen mjedisore:

a) kryerjen e kërkimeve, analizave e bashkëpunimeve shkencore dhe propozimin e metodave e të teknikave inovative për rritjen e efektshmërisë së sektorit të mjedisit, përfshi implementimin e teknologjive inovative me impakt sa më të vogël në mjedis;

b) projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e sistemit të integruar të informacionit (përfshi atë gjeografik - GIS), si dhe të regjistrave mjedisore, nëpërmjet të cilëve sigurohet informacioni në sektorin e mjedisit;

c) ngritjen dhe administrimin e rrjetit të pajisjeve matëse të treguesve mjedisore dhe të laboratorëve mjedisore, të teknologjisë dhe infrastrukturës mjedisore, të cilat mundësojnë kryerjen në kohë të analizave mjedisore;

ç) mbledhjen, përpunimin dhe regjistrimin e informacionit lidhur me vlerësimin/analizimin e kimikateve dhe trajtimin e tyre si dhe të veprimtarive të tjera të lidhura me këtë funksion.

5.3 Në lidhje me vlerësimin e impaktit mjedisor dhe licencimin:

a) vlerësimin e ndikimit në mjedis të shkaktuar nga projekte, aktivitete të subjekteve të ndryshme dhe fenomene natyrore/klimaterikë etj., duke mundësuar një mjedis brenda standardeve dhe parametrave të kërkuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore, për jetë cilësore dhe të shëndetshme të qytetarëve;

b) përgatitjen e projektdeklaratave mjedisore për programe, plane, strategji, projekte;

c) hartimin e databazës së lejeve mjedisore ku të reflektohen të gjitha aplikimet për leje të bëra nga subjekte të ndryshme;

ç) përgatitjen e formatit standard të kërkesës për leje mjedisi;

d) pranimin e aplikimeve për leje mjedisore dhe realizimin e procedurës së vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik për pajisjen me leje (A, B, C);

dh) verifikimin e saktësisë së informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi (të tipit A, B) dhe përgatitjen e mendimit të argumentuar për ministrin në lidhje me miratimin ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara;

e) kryerjen e oponencës teknike për lejet mjedisore dhe hartimin e opionioneve profesionale;

ë) përcaktimin e përgjegjësive mjedisore dhe vlerësimin e riskut, që ka si objektiv parandalimin e rikuperimit e dëmeve që i shkaktohen mjedisit, organizimin e sektorit për marrjen e masave, rehabilitimin e mjedisit etj.

5.4 Në lidhje me inspektimin dhe kontrollin e veprimtarive lidhur me sektorin e mjedisit dhe ujërave:

a) përgatitjen e raporteve periodike mbi vlerësimin e mjedisit;

b) përgatitjen dhe ndjekjen e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit;

c) sigurimin e kontrollit shtetëror të mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në legjislacionin në fuqi;

ç) kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve përmes një programi tematik mbi bazë risku, të miratuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore, siç parashikohet në ligj dhe në legjislacionin e posaçëm në fuqi;

d) sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit dhe ujërave;

dh) shqyrtimin e ankesave për masat administrative dhe gjobat e vendosura ndaj subjekteve në kuadër të aplikimit të përgjegjësiave mjedisore, detyrimeve monetare të subjekteve të gjobitura etj.

e) bashkëpunimin me inspektoratet e tjera kompetente, në rast se kërkohet prej tyre;

ë) ushtrimin e çdo funksioni tjetër, të përcaktuar në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, lejet e mjedisit dhe inspektimin.

*5.4/1 Në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit krijohet Komisioni i Ankimit të AKM-së, i cili drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm dhe ka në përbërje të tij:*

*a) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për inspektimin dhe kontrollin;*

*b) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për shërbimet mbështetëse;*

*c) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për ankimet;*

*ç) nëpunësin përgjegjës për çështjet juridike/ligjore të agjencisë.*

*5.4/2 Në mungesë të anëtarëve të Komisionit të përcaktuar në pikën 5.4/1, për shkak të mosplotësimit të pozicionit të punës, drejtori i Përgjithshëm cakton zëvendësuesin e njësisë përgjegjëse respektive, deri në plotësimin e vendit vakant.*

*5.4/3 Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Ankimit të AKM-së përcaktohet me urdhr të drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së.*

5.5 Në lidhje me ofrimin e shërbimeve mbështetëse:

a) menaxhimin e buxhetit dhe financës;

b) rregullimin ligjor të marrëdhënieve dhe respektimin e procedurave;

c) sigurimin, garantimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.

6. Agjencitë rajonale të mjedisit kryejnë detyrat, si më poshtë vijon:

a) Japin lejen e mjedisit të tipit “C”, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit;

b) Sigurojnë informacionin nëpërmjet mbajtjes dhe përditësimit të regjistrit me të dhëna për instalimet e kategorisë “C”, që ndodhen brenda territorit ku shtrihet fusha e kompetencave të tyre, përpunimin dhe analizimin e tyre në nivel rajoni, si dhe raportimin/përcjelljen e informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme, në funksion të krijimit të sistemit të integruar të informacionit mjedisor në nivel kombëtar;

c) Inspektojnë lidhur me aspektin mjedisor duke përfshirë aktivitete të tilla si monitorimet, kontrollet dhe auditimet me qëllim sigurimin e ligjshmërisë në çështjet mjedisore sipas sistemit mbi bazë risku dhe përputhshmërinë e aktivitetit të operatorëve me kushtet/kriteret e përcaktuara në lejet mjedisore;

ç) Kryejnë matjet dhe analizat laboratorike mbi treguesit mjedisorë në laboratorë funksionalë për këtë qëllim;

d) Koordinojnë veprimtarinë dhe bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse për mjedisin në njësitë e qeverisjes vendore.

7. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të AKM-së miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm.

8. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm, nëpunësve të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të nëpunësve të agjencive rajonale të mjedisit rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

9. AKM-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e AKM-së përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

10. Agjencitë rajonale të mjedisit kanë stemën, logon dhe vulën e tyre zyrtare. Stema e zyrave përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Rajonale e Mjedisit...(emri i

qarkut ku ka selinë agjencia)”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

11. Vula e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe vulat e secilës agjenci rajonale të mjedisit kanë formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

1. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të AKM-së, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, strukturat aktuale vazhdojnë funksionimin e tyre sipas strukturave dhe organikave të miratuara.

2. Numri i punonjësve, asetet dhe fondet e miratuara për AKM-në dhe ARM-të riorganizohen sipas Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në nivel qendror dhe rajonal.

3. Për nëpunësit civilë aktualë të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit. Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 29.1.2014, “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të agjencive rajonale të mjedisit”, dhe nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të ndryshuar, shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**